

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Diana Sina dhe me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarës M. N. nga Prishtina, për shkak të veprës penale marrje në posedim të pasurisë së luajtshme, nga neni 331 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, PP.nr.763/15, të dt.21.01.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën **29.03.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarës , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

E akuzuara **M. N.**, nga i ati R. dhe e ëma A. e gjinisë Q., e lindur me.... në Gjakovë, e tani me banim në Prishtinë, , ka të kryer shkollën e mesme, e vej- nënë e 3 fëmijëve, amvise, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetas i R Kosovës, me numër personal .....

### Është fajtor

**Sepse:** Se me datën 29.05.2015 rreth orës 14.00 minuta, në Gjakovë shkon te servisi – mobil shop “Ari” aty ku e dëmtuara kishte shkuar që të riparoj telefonin e saj mobil, të cilës ditë më parë, Z. P. shoqja e të akuzuarës, ia kishte dëmtuar telefonin, e kur e akuzuara e vëren në servis të dëmtuarën D. N. M. nga fsh.G. K. Klinë, me forcë ia rrëmben nga dora telefonin e llojit “Iphone 5-S”, e ia kushtëzon kthimin e telefonit me tërheqje të çështjes penale ndaj Z. P. të iniciuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor e dëmtim prone.

-me çka ka kryer veprën penale marrje në posedim të pasurisë së luajtshme, nga neni 331 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 85, 86 par 1, 2 dhe 5 dhe nenit 331 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuares i shqipton:

### VËRJETJE GJYQËSORE

E dëmtuara D. N. M. nga fsh. G. K. Klinë, për të realizuar kërkesën e vet pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00.-** (tridhjetë)Euro. në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.763/2015, të dt. 21.01.2016, kundër të akuzuarës M. N. nga Prishtina, për shkak të veprës penale marrje në posedim të pasurisë së luajtshme, nga neni 331 par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që e akuzuara të shpallet fajtores, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj pasi lexoi aktakuzën dhe pasi muar në shiqim lejen e njoftimit të të akuzuarës, atëherë bënë përmisimin e mbiemrit ashtu që në vend të mbiemrit N. duhet të jetë N., ndërsa shënimet tjera gjeneralë mbesin të pa ndryshuara.

E akuzuara M. N. deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprën jam penduar pa masë dhe premtoi se në të ardhmen nuk do ta përsërisë të njëjtën, shton se këtë veprim e kam kryer duke mos ditur pasojat e kryerjes së saj, nuk kam ditur që ky veprim i imi paraqet veprën penale, pasi që telefoni mobil është e vërtetë që ia kam marrë D. M., por atë ia kam marrë me qëllim që e njëjta të më kompensoi shumë prej 60 Euro, pasi që më parë këtë telefon unë e kam riparuar, por e njëjta këto të holla nuk mi ka kthyer, prandaj unë në afekt e kam kryer këtë veprim për të cilën veprën jam penduar por telefonin ia kam kthyer të dëmtuarës D., shton se për herë të parë paraqitem në gjykatë për një veprën të kryer penale, jam nënë e tre fëmijëve, jam e pa punë, prandaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara M. N.: Se me datën 29.05.2015 rreth orës 14.00 minuta, në Gjakovë shkon te servisi – mobil shop “Ari” aty ku e dëmtuara kishte shkuar që të riparojë telefonin e saj mobil, të cilën ditë më parë, Z. P. shoqja e të akuzuarës, ia kishte dëmtuar telefonin, e kur e akuzuara e vëren në servis të dëmtuarën D. N. M. nga fsh. G. K. Klinë, me forcë ia rrëmben nga dora telefonin e llojit “Iphone 5-S”, e ia kushtëzon kthimin e telefonit me tërheqje të çështjes penale ndaj Z. P. të iniciuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor e dëmtim prone.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga e akuzuara, e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjyqësore konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 73 të KPRK-ës, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e saj, sjelljen korrekte të të akuzuara në gjykim, gjendjen e saj të dobët ekonomike, është e vej, nënë e tre fëmijëve, mbajtëse e vetme e familjes, sjelljet e kryesit në të kaluarën se e akuzuara më parë nuk ka qenë e dënuar, sjelljet e saj pas kryerjes se veprës, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuara t'i shqiptoj vërejtje gjyqësore, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë komfor nenit 450 par.1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr.33/16 dt.29.03.2017**

**Sekretarja Juridike**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15** ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.